



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi  
Mbledhja nr. 15 - 2009  
Prishtinë, më 04 maj 2009, ora 14:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi dhe Armend Zemaj.

**Munguan:** Branislav Grbiq dhe Dzezair Murati.

**Të pranishëm:** Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi – NDI, Lejla Selimi - OSBE, dhe Naim Hajdari – EULEX.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit:

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 prillit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar;
4. Konsultimi lidhur me takimin e përbashkët me Komisionin për Integritet Evropian, përkritazi me identifikimin e detyrave të fushëveprimit të Komisionit

Për Legjislacion dhe Gjyqësi, të përcaktuara me propozimplanin e veprimit të Kuvendit të Kosovës, në vështrim të objektivave që përmban Raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2008.

5. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi përfaqësuesit e mediave e të organizatave që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi për rendin e ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar**

**Kryetari** - Lidhur me Projektligjin shtoi se e kemi miratuar në parim në seancë plenare. Disa deputetë patën vërejtje, por vërejtje patën edhe disa zyra që na mbështesin. Kemi edhe disa konstatime nga Zyra Ligjore e Kuvendit. Nëse jeni të pajtimit mund të caktojme edhe raportues. Ai do t'i marrë të gjitha vërejtjet, duke përfshirë edhe ato të faktorit ndërkombëtar. Amendamentet i bëjmë së bashku dhe nen për nen e shqyrtojmë Projektligjin, që nuk është shumë voluminoz. Edhe anëtarët e Komisionit ishin të mendimit të mos caktohet raportues, por të shqyrtohet çdo nen veç e veç.

**Adem Hajdaraj** – Sipas tij në titull të këtij projektligji kemi të bëjmë me dy definicione të ndryshme. Propozoi që në vend të fjalës “apo” të jetë “ose”- “Shqyrtimi i Projektligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar”

**Kryetari** – Theksoi se nuk do duhej të quhej Projektligji për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, por të quhet Projektligji për themelimin e agjencisë së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sepse Projektligji në tërësi flet për themelimin e agjencisë së menaxhimit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

**Adem Salihaj** – Tha se ky projektligj i ka në vete dy çështje: themelimin e agjencisë dhe menaxhimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, prandaj është vështirë të formulohet.

**Kryetari** – Duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi se qëllimi i këtij projektligji është themelimi i agjencisë së menaxhimit dhe të sekuestrimit të pasurisë, sepse po të ishte themeluar me urdhëresë, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, nuk do të kishte nevojë të thuhej “Themelimi”.

**Ibrahim Makolli** – Sipas tij nuk do të duhej të ishte ligji për themelimin e agjencisë, sepse vetë ligji e përcakton formën e themelimit, kështu që nuk e di a do të mund të thuhej: “Themelimi dhe Menaxhimi”.

**Selviye Halimi** - Propozoj të jetë: “Ligji për agjencinë e menaxhimit të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar – pra të mos përmendet fare: ” Themelimi”, sepse këtu e kemi përkufizimin: çka janë sekuestrimi dhe konfiskimi. Prandaj nuk e di cila do të ishte më e arsyeshme “apo” “ose”.

**Armend Zemaj** - Sipas tij termi “agjenci” nuk e di a do të ishte adekuat, sepse më i përshtatshëm do të ishte të quhej “Departament “. Departamenti i rregulluar me ligj në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ndoshta do të ishte më funksional, sepse nëse është agjenci, atëherë është agjenci ekzekutive. Veçmas i rikujtoi vështirësitë e implementimit të këtij ligji.

**Bajram Kosumi** – Theksoi se duhet të bëhen ndryshime në themelimin e agjencisë. Ishte propozim ta themelonte Qeveria, e jo Ministria dhe t’i përgjigjet Qeverisë. Në parim jam për reformën e administratës dhe shtoi se kjo që është në ligj nuk është as agjenci, as departament. Ishte i mendimit të caktohej raportuesi, sepse është një çështje e ndjeshme.

**Kryesuesi** – Adem Salihaj, pyeti anëtarët e Komisionit se a jeni të pajtimit të quhet menaxhim apo administrim, sepse fjala administrim i përgjigjet më shumë. Ky propozim u miratua nga anëtarët e Komisionit dhe gjithkund ku është fjala *menaxhim* të zëvendësohet me fjalën *administrim*.

**Armend Zemaj** – Në fjalën e sërishme ceku se nuk është vetëm çështja e titullit të këtij projektligji, mirëpo rëndësia e tij shpaloset në çështjet e adresuara të fushëveprimin e tij.

**Ibrahim Makolli** – Në diskutimin e tij të sërishëm shtoi, nëse këtu themi “themelimin” dhe nuk i përcaktojmë formën dhe përmbajtjen e themelimit, do të mbetet hapësirë të bëjë secili çka të dojë. Nëse hartojmë ligj vetëm për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar, kurse themelimin e bën me një vendim të veçantë Qeveria ose Ministria, atëherë nuk kemi pse të bëjmë ligj për themelimin, por vetëm për menaxhimin, sepse ata e themelojnë.

]

**Kryesuesi** – Adem Salihaj vazhdoi nga neni 5 e tutje i Projektligjit, sepse për nenet e më sipërme do të ftohen zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë për sqarime. Për nenin pesë nuk pati vërejtje.

**Kryetari** - Më vonë mori pjesë në mbledhje dhe vazhdoi me nenin 6. U propozua që pika 5 e këtij neni të hiqet, ndërsa pika 4 e këtij neni të bartet te neni 5 - si pika 3.

Në nenin 9, pika 4, rresht 5, të shtohet fjalia: “Mjetet nga shitja e pasurisë së konfiskuar pas vendimit të formës së prerë nga gjykata shkojnë në buxhetin e Kosovës.

Pas një debati për këtë pikë, Komisioni mori këtë vendim: te neni 12, pika 2, rreshti 2, të hiqen fjalët ‘do të mirren’ dhe zëvendësohen me fjalët “Ministria duhet të nxjerrë” dhe vazhdon teksti.

P e r f u n d i m

Për çështjen e strukturës së agjencisë të ftohen zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë për sqarime dhe të përgatiten edhe propozimamendamentet e Komisionit që të diskutohen në takim të përbashkët.

Procesverbali u hartua nga Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni